

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6213
E enjte, 14 janar 2021
çmimi 0.40 €

Kryeministri në detyrë shikon nga afër dëmet e shkaktuara nga vërshimet

 | FAQE 8

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NGA 13 DERI MË 21 JANAR ËSHTË PERIUDHA E REGJISTRIMIT PËR TË VOTUAR NGA MËRGATA

 | FAQE 4-5

BIEN ZGJEDHJET E PARTITË POLITIKE KUJTOJNË DIASPORËN



Periudha e aplikimit/regjistrimit për votim përmes postës në zgjedhjet e 14 shkurtit ka filluar. Prej 13 deri më 21 janar është afati kur diaspora mund të regjistrohet për të votuar në ditën e

zgjedhjeve. Kjo kohë i ka nxitur partitë politike që t'i bëjnë thirrje diasporës që të regjistrohet dhe të votojë. Liderët politikë ia kanë rikujtuar diasporës rëndësinë e votës, duke

prezantuar edhe oferta që ato kanë për diasporën. Për ta marrë votën e diasporës, partitë politike këtë herë kanë vendosur në lista për deputetë edhe përfaqësues të diasporës

OPINION

ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PARLAMENTARE NË KOSOVË DHE PJESËMARRJA E KOMUNITETIT BOSHNJAK

 | F. 11

Shkruan:
Çerim Bajrami



AKTUALE

SAMEDIN MEHMETI EMËROHET DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS

 | F. 7

PKD-JA NË ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT GARON ME SLOGANIN "RIMËKËMBJE"

 | F. 3

EKONOMI

ODA E HOTELERISË KUNDËR TUBIMEVE TË PARTIVE POLITIKE

 | F. 9

MUHARREM NITAJ EMËROHET MINISTËR NË DETYRË I EKONOMISË DHE I AMBIENTIT

 | F. 9

SPORT

SYNOJMË SUPERKUPËN, POR FOKUSI KRYESOR ËSHTË NË KUPË

 | F. 12

SBASHK-u: OPSIONI I GREVËS NË ARSIM MBETET I HAPUR

 | FAQE 3

VERIFIKIMI I KANDIDATËVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE, DAKA TAKON KRYESUESIN E KGJK-së

 | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Itali, nis gjyqi më i madh kundër mafias në dekada

ROMË, 13 JANAR - Qindra anëtarë të dyshuar të grupit mafioz më të fuqishëm të Italisë po përballen me drejtësinë. Gjykimi i 355 anëtarëve të dyshuar të rrjetit të gjerë të krimit "Ndrangheta", si dhe politikanëve, avokatëve, biznesmenëve dhe të tjerëve të akuzuar, filloi në rajonin jugor të Kalabrisë më 13 janar. Ky konsiderohet të jetë procesi gjyqësor më i madhi për krim të organizuar në Itali pas më

shumë se 30 vjetësh. Të dyshuarit po përballen me akuza duke përfshirë vrasje, trafik droge, zhvatje dhe pastrim parash. Më shumë se 900 dëshmitarë pritët të paraqiten në gjykim, i cili po zhvillohet në një ndërtesë të sigurisë së lartë në qytetin e Lamezia Terme, e cila është në zemër të territorit ku vepron "Ndrangheta". Prokurori Nicola Gratteri u tha gazetarëve se gjyqi do të

"zbulonte një pasqyrë se çfarë është mafia kalabreze sot - jo më një mafi barinjsh që rrëmbejnë, por një korporatë e madhe kriminale".

"Ndrangheta" thuhet se është mafia më e fuqishme në Itali, me celulat e saj të shpërndara në të gjithë botën. Asnjë gjyq i një shkalle të tillë kundër mafias nuk është mbajtur në Itali që nga vitet 1980. I pandehuri i profilit më të lartë është shefi i klanit, 66-vjeçari Luigi Mancuso.



Irani mban stërvitje raketore



TEHRAN, 13 JANAR - Ushtria iraniane ka nisur stërvitjet e raketave detare me rreze të shkurtër në Gjirin e Omanit, raportuan mediat shtetërore. Televizioni shtetëror tha më 13 janar se anija luftarake logjistike Makran, e përshkruar si anija ushtarake më e madhe e Iranit, dhe anija që shërben për lëshimin e raketave Zereh, po merrnin pjesë në stërvitjet dyditore. Tensionet midis Shteteve të Bashkuara dhe Iranit janë rritur që nga viti 2018, kur presidenti amerikan

Donald Trump tërhoqi Uashingtonin nga një marrëveshje bërthamore ndërkombëtare midis Teheranit dhe fuqive botërore, duke argumentuar se marrëveshja e vitit 2015 nuk ishte e mirë. Administrata amerikane gjithashtu vendosi sanksione shkatërruese mbi Iranin në një përpjekje për ta detyruar Teheranin të negocionte një marrëveshje të re që do t'i adresonte gjithashtu programet raketore të vendit

dhe mbështetjen e tij për grupet militante në vendet e tjera të rajonit. Si përgjigje ndaj tërheqjes së ShBA-së nga marrëveshja dhe vendosjes së sanksioneve ekonomike, Irani, i cili pretendon se programi i tij bërthamor është për qëllime civile, ka shkelur gradualisht pjesë të paktit, siç është pasurimi i uraniumit. Në një fjalim televiziv gjatë një takimi të kabinetit më 13 janar, presidenti iranian Hassan Rohani tha se sanksionet e ShBA-së do të dështonin.

Gjermania nuk do t'i heqë kufizimet në muajin shkurt

BERLIN, 13 JANAR - Gjermania nuk do të jetë në gjendje t'i heqë të gjitha masat që synojnë ta frenojnë përhapjen e koronavirusit në fillim të shkurtit, tha ministri i Shëndetësisë së Gjermanisë, Jens Spahn. "Një gjë është e qartë: nuk do të jetë e mundur të shfuqizohen të gjitha kufizimet më 1 shkurt", i tha Spahn radios Deutschlandfunk të mërkurën, duke shtuar se do

të duheshin edhe dy ose tre muaj për t'i arritur efektet e fushatës së vaksinimit. Revista "Bild" raportoi të martën se kancelarja Angela Merkel kishte thënë në një takim të ligjvënësve, se masat aktuale të izolimit mund të zgjasin deri në fillim të prillit. Kabineti gjerman do të takohet të mërkurën për të miratuar kontrolle më të rrepta për njerëzit që hyjnë në Gjermani.

Sipas rregullave të reja, udhëtarëve nga vendet me numër të lartë të të infektuarve, apo nga ato ku po qarkullon një variant i ri i koronavirusit, do t'u kërkohet të bëjnë një test të koronavirusit. Instituti gjerman për Sëmundjet Infektive "Robert Koch" (RKI) raportoi të mërkurën për 19 600 raste të reja të të infektuarve me koronavirus.



Navalny planifikon të kthehet në Rusi



MOSKË, 13 JANAR - Kritiku i hapur i Kremlinit, Aleksei Navalny, i cili është aktualisht në Gjermani, shkroi në "Twitter" se ai planifikon të kthehet në Rusi më 17 janar. Navalny u sëmur gjatë një fluturimi nga Tomsk për në Moskë, në gusht të vitit 2020, dhe u vendos në një gjendje kome në një spital në Siberi, para se të transferohej në një institucion të klasës botërore në Gjermani. Testet laboratorike të kryera në

Gjermani, Francë dhe Suedi kanë vërtetuar se Navalny ishte helmuar me një agjent nervor të klasës Novichok, një rezultat i konfirmuar edhe nga Organizata Ndërkombëtare për Ndalimin e Armëve Kimike. Pas helmimit të tij, Bashkimi Evropian vendosi sanksione ndaj gjashtë zyrtarëve rusë dhe një instituti kërkimor shtetëror. Autoritetet ruse kanë pretenduar se asnjë gjurmë helmi nuk është gjetur në trupin e Navalny para se ai të

transferohej në Gjermani dhe kanë refuzuar të hapin një hetim penal për incidentin. Në fund të muajit të kaluar Shërbimi Federal i Burgjeve i Rusisë i tha Navalnyt të kthehej menjëherë nga Gjermania ose do të përballlej me burg në Rusi për shkeljen e kushteve të një dënimi me burg të vitit 2014. Navalny ka akuzuar presidentin, Vladimir Putin, për urdhërimin e helmimit, një pretendim i hedhur poshtë nga Kremlini.

PDK-ja në zgjedhjet e 14 shkurtit garon me sloganin 'Rimëkëmbje'

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 JANAR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka shpallur sot planin qeverisës të Partisë Demokratike të Kosovës për rimëkëmbje të Kosovës. Në një konferencë për media, Hoxhaj ka treguar prioritetet e PDK-së për

qeverisjen e ardhshme të udhëhequr nga ai, si dhe ka folur për mënyrat e implementimit në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Hoxhaj, po ashtu, ka ftuar Albin Kurtin që të dalin përballë njëritjetrit në debat publik për t'i krahasuar planet dhe platformat e të dy partive, pasi ka thënë se gara në këto zgjedhje është në mes të PDK-së dhe LV-së. "Sot Kosova

kërcënohet nga katër rreziqe. Dy prej tyre, pandemia dhe pasojat e saj ekonomike, janë rreziqe globale. Megjithatë, rrezik nacional është mënyra se si është menaxhuar pandemia dhe mënyra se si jemi përgatitur për periudhën pas pandemisë. Fatkeqësisht, Kosova po dështon në të dy aspektet. E kjo është një arsye e fortë për t'u shqetësuar. Rreziku i tretë buron prej

mungesës së stabilitetit politik dhe krizave të vazhdueshme të klasës sonë politik. Nuk është koha për hasmëri tradicionale politike. Klasa politike duhet t'u dalë në ballë sfidave dhe pritshmërive të qytetarëve. Qytetarët kërkojnë konsistencë, leadership të sprovuar, stabilitet, siguri. Qytetarët janë lodhur prej hasmërive partiake. Kushtetuta jonë, sistemi ynë, e kërkojnë dhe e

promovojnë bashkëpunimin. Punën ekipore. Rreziku i katërt vjen nga Haga. Nuk janë duke u gjykuar thjesht heronjtë tonë, themeluesit e shtetit tonë. Është duke u gjykuar ekzistenca jonë si shtet", ka thënë Hoxhaj. Ai ka bërë me dije se tash është koha që partitë ta dëshmojnë respektin e tyre për proceset demokratike. "Kjo është ajo çfarë bën PDK-ja", ka thënë Hoxhaj.



SBASHK-u: Opsioni i grevës në arsim mbetet i hapur

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 JANAR - Këshilli Drejtues i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) në Kosovë ka mbajtur një takim të jashtëzakonshëm së bashku me kryetarët e kuvendeve të arsimit parauniversitar të komunave të Kosovës dhe universiteteve. Në këtë takim është diskutuar për situatën aktuale në arsim dhe për kërkesat e anëtarësisë lidhur me shtesën në paga për arsye të punës dhe kushteve të

vështirësuar nga pandemia dhe rreziku nga prekja me Covid-19 dhe për kontratën e re kolektive të arsimit. "Pas një debati të hapur, duke vlerësuar edhe situatën aktuale në Kosovë dhe duke analizuar me kujdes këto dy kërkesa të anëtarësisë, pjesëmarrësit e këtij takimi të jashtëzakonshëm kanë sjellë përfundimin se periudha e dytë e mësimit të nisë më 18 janar, por që greva të mbetet opsion i hapur. Është autorizuar kryesia dhe kryetari i SBASHK-ut, që nëse edhe në ditët në vijim nuk ka rezultate nga takimet me

institucionet dhe dialog atëherë, duke marrë mbështetjen me shkrim nga anëtarësia përmes formularëve të deklarimit, që do të shpërndahen të premtën e tutje në të gjitha institucionet arsimore, të shpallen veprimet sindikale, duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut. Në këtë komunikatë thuhet se pjesëmarrësit janë shprehur të bindur se qeveria Hoti dhe MASH-i do të reflektojnë duke u dhënë përgjigje pozitive këtyre dy kërkesave të anëtarësisë së SBASHK-ut.

Kosova regjistron edhe një viktimë dhe 299 të infektuar me Covid

PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka regjistruar të mërkurën 299 raste të reja me Covid-19 pas testimit të

1 825 mostrave. Sipas këtij Instituti, në 24 orët e fundit është regjistruar një viktimë, duke e çuar në 1 388 numrin e të vdekurve me këtë virus prej kur ka

shpërthyer pandemia. Sipas IKShPK-së, të mërkurën nga Covid-19 janë shëruar 526 persona, kurse raste aktive janë 5 567. Prej 13 marsit, kur janë

regjistruar rastet e para me Covid në Kosovë, autoritetet shëndetësore në këtë shtet kanë regjistruar 54 560 persona të infektuar me këtë virus.





NGA 13 DERI MË 21 JANAR ËSHTË PERIUDHA E REGJISTRIMIT PËR TË VOTUAR NGA MËRGATA

BIEN ZGJEDHJET E PARTITË POLITIKE KUJTOJNË DIASPORËN

Periudha e aplikimit/regjistrimit për votim përmes postës në zgjedhjet e 14 shkurtit ka filluar. Prej 13 deri më 21 janar është afati kur diaspora mund të regjistrohet për të votuar në ditën e zgjedhjeve. Kjo kohë i ka nxitur partitë politike që t'i bëjnë thirrje diasporës që të regjistrohet dhe të votojë. Liderët politikë ia kanë rikujtuar diasporës rëndësinë e votës, duke prezantuar edhe oferta që ato kanë për diasporën. Për ta marrë votën e diasporës, partitë politike këtë herë kanë vendosur në lista për deputetë edhe përfaqësues të diasporës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 JANAR - Ka filluar të mërkurën periudha e aplikimit/regjistrimit për votim përmes postës në zgjedhjet e 14 shkurtit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se ky afat do të jetë nga 13 deri më 21 janar 2021. Kjo ka bërë që partitë politike, si asnjëherë më parë, t'i drejtohen diasporës me mesazhe të ndryshme për t'u regjistruar dhe votuar më 14

shkurt. Madje liderët politikë kanë bërë me dije se vota e diasporës për këto zgjedhje do të jetë shumë e rëndësishme. Për ta marrë votën e mërgatës ata kanë prezantuar edhe ofertën për këtë pjesë të qytetarëve.

Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër, Albin Kurti, përmes një videoadresimi për publikun, ka thënë se për fitoren e tij në këto zgjedhje nevojitet secila votë e diasporës. "Të dashur

bashkatdhetarë, data e zgjedhjeve tashmë është caktuar, 14 shkurti. Afatet e procesit për aplikim për votim janë shpallur dhe janë të shkrjuara. Qendrat tona në mërgatë kanë përgatitur këtë video sqaruese për ta lehtësuar votimin tuaj. Shikojeni videon dhe ndiqni me kujdes hapat dhe afatet e theksuar në të", ka thënë Kurti.

Ai ka deklaruar se vetëm së bashku mund t'ia japin Kosovës një të ardhme më të

mirë. "Mos harroni vota e juaj është shumë e rëndësishme. Secila vota na nevojitet për fitoren e madhe. Të gjithë dhe bashkë i japim Kosovës një të ardhme më të mirë", është shprehur Kurti.

Edhe kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kandidati për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka ftuar bashkatdhetarët që të regjistrohen për të votuar në zgjedhjet e 14 shkurtit.

Hoxhaj ka thënë se PDK-ja ka plan konkret për diasporën, duke përfshirë vende në listën për deputetë, ulëse të rezervuara për diasporën në Kuvendin e Kosovës dhe rikthimin e Ministrisë së Diasporës. "Të dashur bashkatdhetarë, sot është hapur afati për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës. Ju ftoj të gjithëve që të regjistroheni deri më 21 janar dhe ta

shfrytëzoni të drejtën për ta bërë ndryshimin në vendin tonë. PDK-ja ka plan konkret për diasporën, përfshirë tri vende në listën për deputetë, ulëse të rezervuara për diasporën në Kuvendin e Kosovës, rikthimin e Ministrisë së Diasporës me ministër nga Diaspora dhe lirin nga obligimet e sigurimit kufitar. Bashkë për rimëkëmbjen e Kosovës", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se më 14 shkurt diaspora duhet të jetë me Kosovën. "U bëj thirrje njerëzve, që jeta i ka degdisur nëpër vende të ndryshme të botës, të jenë në Kosovë, të jenë me Kosovën më 14 shkurt. Të jenë me njerëz të duhur të Kosovës, të jenë me ata që i mbesin besnik Kosovës, qytetarëve të Kosovës, të gjithë neve. Aleanca i ka këta njerëz,

këtu i kam me vete dy kolege që e kanë fokusim diasporën. Njëra është ministrja Haradinaj-Stublla, tjetra është deputetja Time Kadrija e cila ka në fokus diasporën në kuadër të partisë sonë AAK-së”, ka thënë Haradinaj në një konferencë për media.

Ai ka treguar se kjo parti do të ketë në listë për deputetë kandidatë nga diaspora. “Arbnora Hasani, një zonjë e respektuar nga rrethi i Mitrovicës, e cila jeton në Gjenevë, është kandidatë për deputete nga diaspora. Ajo është një vajzë e ngritur me përvoja menaxheriale, e cila do ta përfaqësojë mërgatën si kandidatë për deputete në këto zgjedhje. Ndërsa në të ardhmen Aleanca do t'i përkrahë ndryshimet për reformën zgjedhore për vendet e rezervuara për diasporën në

Kuvendin e Kosovës”, ka thënë Haradinaj.

KQZ-ja do ta verifikojë procesin e aplikimit për regjistrim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) pritet ta miratojë edhe një udhëzim lidhur me vendimin e datës 11 janar për verifikimin e aplikacioneve për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, ka deklaruar kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka. Në bazë të këtij vendimi, KQZ-ja do t'u telefonojë të gjithë personave që janë jashtë vendit dhe të cilët aplikojnë për votim për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të Kosovës, të cilat do të mbahen më 14 shkurt. Sipas këtij vendimi, KQZ-ja do t'i refuzojë

aplikacionet e atyre që nuk lajmërohen në telefon në kohën kur ky institucion i thërret për verifikim. “KQZ-ja, duke marrë parasysh që vota nga diaspora është lehtë e cenueshme dhe shumë lehtë e manipulueshme, ka marrë një vendim me të cilin do ta bëjë verifikimin e të gjitha votave të cilat vijnë nga diaspora, respektivisht do të bëhet verifikimi i identitetit të aplikuesve dhe do të vlerësojmë se a janë ata aplikues për regjistrim si votues jashtë Kosovës me të vërtetë votuesit të cilët kanë të drejtë ligjore që të votojnë apo është duke votuar dikush në emër të tyre”, ka deklaruar për medie Daka.

Ajo ka treguar se në atë udhëzim do të përshkruhet mënyra e verifikimit dhe të gjitha çështjet të cilat janë ngritur në opinion. Ndaj këtij vendimi të KQZ-së ka

reaguar edhe ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, e cila përmes një shkrimi në rrjetin social “Facebook” ka thënë se ky vendim mund të krijojë rrethana me të cilat e drejta e votës shkelet në mënyrë flagrante. Gjithashtu, ndaj këtij vendimi ka reaguar edhe Albuena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje, ani pse anëtarët e kësaj partie në KQZ kishin votuar për këtë vendim. “E drejta e votës është e pacenueshme. Ajo nuk mund të pamundësohet vetëm sepse dikush ‘nuk e ka hapur telefonin’, kishte shkruar Haxhiu.

Më pas, Lëvizja Vetëvendosje më 12 janar ka njoftuar se ka dorëzuar ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për vendimin e KQZ-së lidhur me

verifikimin e aplikacioneve për votim të mërgatës. Në një komunikatë për media, Lëvizja Vetëvendosje ka theksuar që për t'i shmangur problemet dhe komplikimet “përfaqësuesit e LV-së janë pajtuar që aplikimi për regjistrim të verifikohet vetëm për rastet me mospërputhje sipas procedurave, kur nga një e-mail adresë dërgohen shumë aplikacione me mbiemra të ndryshëm dhe numër të njëjtë telefoni”. “Për zbatimin dhe vendimin, KQZ-ja duhet të hartojë një udhëzim administrativ, i cili rregullon mënyrën e hollësishme të verifikimit. Ai pritet të miratohet sot. Ky udhëzim duhet të përjashtojë çdo mundësi të largimit të votuesve nga lista e votimit përmes një telefonate”, është thënë në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.

Avokati i Popullit, partive politike: Në listat e kandidatëve për deputetë të respektohet barazia gjinore



Prishtinë, 13 janar (ER) - Avokati i Popullit përmes një deklarate për media ka folur për procesin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës që do të mbahen më 14 shkurt. Avokati i Popullit përmes kësaj deklarate ka bërë me dije se është duke ndjekur me vëmendje procesin për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ai ka vlerësuar rëndësinë që kanë zgjedhjet brenda një sistemi demokratik, duke theksuar se procesi zgjedhor për të qenë i pakontestueshëm duhet të jetë

i mbështetur fuqishëm mbi parimet dhe garancitë që i kanë vendosur Kushtetuta dhe ligjet e vendit.

Me këtë rast, Avokati i Popullit u bënë thirrje partive politike që t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, përkatësisht nenit 6 dhe nenit 14 të ligjit, në listat e kandidatëve për deputetë që të respektohet barazia gjinore, respektivisht përfaqësimi prej pesëdhjetë përqindësh (50 për qind) për secilën gjini.

Avokati i Popullit, duke marrë parasysh reagimin e publikut lidhur me vendimin nr. 42-

2021 të datës 11 janar 2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrimin për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosovës, thekson se procesi i verifikimit të aplikacioneve është i domosdoshëm për garantimin e besueshmërisë së procesit zgjedhor. “Megjithatë, e drejta për të zgjedhur është e drejtë e garantuar për secilin person që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Përderisa ligji garanton të drejtën për të zgjedhur jashtë vendit, është detyrim i shtetit që procesi zgjedhor të organizohet në mënyrë të mirëfilltë në praktikë ashtu që të mundësohet që zhvillimi i këtij procesi të jetë i drejtë dhe demokratik, duke mundësuar përfshirje sa më të madhe të qytetarëve me të drejtë vote. Prandaj, është e domosdoshme që KQZ-ja ta evitohet çfarëdo veprimi i cili do të mund ta kufizonte esencën e së drejtës për të zgjedhur të votuesve jashtë Kosovës, të garantuar me kornizën ligjore të vendit”,

theksohet në këtë deklaratë. Avokati i Popullit u bënë thirrje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe partive politike që ta kenë parasysh situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 dhe gjatë aktiviteteve që ndërliken me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës që do të mbahen më 14 shkurt 2021, t'i respektojnë në mënyrë rigorozë rekomandimet e IKShP-së dhe masat e vendosura nga Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e pandemisë Covid-19.

Lladrovci: Angazhimi i komunës për sanimin e gjendjes nga vërshimet po vazhdon

DRENAS, 13 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar qytetarët për bashkëpunim, Qendrën Operative Emergjente, FSK-në, policinë, zjarrfikësit dhe

të gjithë aktorët e tjerë që bashkë po angazhohen për tejkalimin e situatës së rënduar pas reshjeve. Kryetari Lladrovci ka theksuar se angazhimi për sanimin e gjendjes po

vazhdon. "Ka disa ditë që komuna jonë është duke u ballafaquar me vërshime. Falënderoj qytetarët për bashkëpunim, Qendrën Operative Emergjente, FSK-në, policinë, zjarrfikësit,

administratën e Komunës së Drenasit dhe institucionet qendrore që u gjenden pranë nesh në këto ditë të rënda për komunën. Në disa vende tashmë uji është tërhequr, siç shihet në videon dhe

fytyrën e Albert Sinanit, të realizuara enkas për gjendjen në terren dhe nivelin e ujit në komunën tonë", ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryeministri në detyrë shikon nga afër dëmet e shkaktuara nga vërshimet

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka vizituar të mërkurën Komunën e Vushtrrisë për t'u njoftuar nga afër me dëmet të cilat i kanë shkaktuar kësaj komune reshjet atmosferike të ditëve të fundit. I shoqëruar nga zëvendëskryeministri Driton Selmanaj dhe kryetari i

Angazhimi i njësiteve të FSK-së në operacionet e shpëtimit pas vërshimeve

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), pas reshjeve të vazhdueshme ditët e fundit dhe vërshimeve në gjithë territorin e Kosovës, me njësitet e specializuara për reagim në kriza, ekipet e kërkim-shpëtimit dhe të xhenios, u doli në ndihmë qytetarëve dhe



masat për ta vlerësuar situatën në terren, duke angazhuar Kompaninë për Operacione me Civil në nivel vendi. Më datën 08.01.2021 janë pranuar kërkesat e para për mbështetje nga Komuna e Gjakovës, përmes institucioneve qeveritare për t'i mbështetur autoritetet civile, për zhvendosjen dhe strehimin e 55 qytetarëve në Aeroportin e Gjakovës. Në ditët në vazhdim, ekipet e kërkim-shpëtimit kanë intervenuar në fshatin Kuzmin të Fushë-Kosovës, ku kanë shpëtuar tre qytetarë të ngjuar në shtëpitë e tyre. Operacionet e FSK-së kanë vazhduar edhe më 10, 11 e 12

janar, për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve dhe institucioneve në përballimin e situatës emergjente. FSK-ja i ka dalë në ndihmë Policisë së Kosovës, në pengimin e përmbytjes së objektit të Forenzikës të Policisë së Kosovës, ku janë angazhuar ekipet Xheniere të Gardës Kombëtare, gjithashtu kanë intervenuar edhe në Klinikën e Pulmologjisë në QKUK-së, ku kanë penguar përmbytjen e objektit. Njësitet e Kërkim-Shpëtimit në ujëra, më 11.01.2021, gjatë ditës dhe natës kanë vepruar në rajonin e Drenasit, në fshatrat Poklek, Shtrubullojë e Komaran, ku kanë shpëtuar 43

qytetarë të ngjuar në shtëpitë e tyre.

Ekipet e Kërkim-Shpëtimit, po këtë ditë, kanë shpëtuar dhe evakuuar tre banorë të fshatit Volljak të Klinës. Më 12 janar ekipet profesionale të FSK-së kanë realizuar operacione të kërkim-shpëtimit edhe në Komunën e Fushë-Kosovës, Vushtrrisë dhe Prizrenit, ku kanë shpëtuar dhe evakuuar 16 persona.

FSK-ja është në gjendje gatishmërie 24 orë në 7 ditë të javës për të intervenuar me kapacitetet e saj operacionale, duke iu përgjigjur kërkesave që vijnë nga institucionet shtetërore. Vërshimet kanë shkatërruar edhe infrastrukturën rrugore, ku janë dëmtuar disa ura. FSK-ja me ekipet e Xhenios kanë bërë vlerësimin e urës së dëmtuar në fshatin Dobroshec të Drenasit dhe urës në fshatin Hajnoc të Kamenicës, me qëllim të ngritjes së urave mobile të FSK-së për ta mundësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve. Forca e Sigurisë së Kosovës ka bërë me dije se është e përgatitur për t'iu dalë në ndihmë institucioneve të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve në raste të situatave emergjente si në, kërkim-shpëtimit në ujëra, male dhe kërkim-shpëtimit urban.



Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, kryeministri Hoti ka vizituar urën mbi lumin Silnica, afër Fabrikës së Lllamarinës, për të parë nga afër dëmet që ka shkaktuar dalja nga shtrati e këtij lumi. Me këtë rast, ai ka paralajmëruar takimin që do ta zhvillojë nesër me kryetarët e të gjitha komunave për të diskutuar lidhur me dëmet e shkaktuara nga vërshimet dhe formimin e komisionit për vlerësimin e këtyre dëmeve. Kryeministri Hoti edhe një herë ka përgëzuar FSK-në, Agjencinë e Emergjencave dhe Shtabet Lokale të cilat pandërprerë janë në terren në mbikëqyrje të situatës dhe ofrim të ndihmës për qytetarët dhe familjet e prekura nga vërshimet.

institucioneve shtetërore në përballimin e situatës, me fokus të veçantë në shpëtimin e jetës së njerëzve. Pas vërshimeve të para (06.01.2021), FSK-ja ka marrë



Komuna e Kamenicës shpall gjendje emergjente

PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, pas gjendjes së krijuar nga vërshimet, ka marrë vendim për shpallje të gjendjes emergjente. I pari i

komunës, Qëndron Kastrati, përmes këtij vendimi obligon Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, që të koordinojë dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për evidentimin e dëmeve dhe

sanimin e tyre, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera relevante në komunë. Ekipet komunale dhe ekipet e zjarrfikësve janë gjatë gjithë kohës në terren për sanimin e

problemeve aty ku ka nevojë. "Për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës, të cilët vazhdojnë të kenë problem nga vërshimet e ditëve të kaluara, këta numra janë në dispozicion për

kontakt: 080011010 deri në orën 16:00, ndërsa edhe pas orës 16:00 të kontaktojnë në numrin 045549182, në çdo kohë që ata kanë nevojë", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

Verifikimi i kandidatëve të subjekteve politike, Daka takon kryesuesin e KGJK-së

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 JANAR - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka takuar të mërkurën kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skënder Çoçaj. Në njoftimin për media të KQZ-së thuhet se u diskutua lidhur me procesin e verifikimit të kandidatëve të subjekteve politike, të cilët duan të marrin pjesë në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 14 shkurt 2021. Daka dhe Çoçaj u pajtuan për bashkëpunim institucional për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se periudha e aplikimit/regjistrimit për votim përmes postës është nga 13 deri më 21 janar 2021.

KQZ-ja njofton se të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës me të drejtë vote që jetojnë jashtë vendit mund të aplikojnë për regjistrim për të votuar përmes postës. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve inkurajon të gjithë qytetarët me të drejtë vote, që jetojnë jashtë Kosovës dhe që i



plotësojnë kriteret ligjore përkatëse që të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, pastaj edhe të votojnë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka njoftuar KQZ-ja.

Gjatë kësaj periudhe shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës mund të aplikojnë për regjistrim për të votuar përmes postës për zgjedhjet e parakohshme që do të mbahen më 14 shkurt 2021. Gjithashtu, edhe ata/ato

që nuk kanë shtetësinë e Republikës së Kosovës, por që kanë të drejtë të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, sipas Ligjit për Shtetësi, mund të aplikojnë. "Në këtë afat të përcaktuar nga KQZ-ja, aplikimi për t'u regjistruar si

votues jashtë Kosovës mund të bëhet përmes këtyre mundësive: fahut postar të KQZ-së; fax-it të KQZ-së dhe përmes ndonjëres nga e-mail adresat e shërbimit votues të KQZ-së", theksohet në njoftimin e KQZ-së.

Samedin Mehmeti emërohet drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës



PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Qeveria në detyrë e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, në pajtim me rregulloren e punës, ka mbajtur mbledhje korresponduese elektronike. Në mbledhjen e 57 me radhë, qeveria ka miratuar vendimin për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe vendimin për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, në

projektin për sigurinë e rrjetit të brendshëm të teknologjisë informative të Policisë së Kosovës.

Qeveria në detyrë i ka propozuar kryeministrit Hoti emërimin e Samedin Mehmetit, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Vendimi do të hyjë në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në mbledhjen e së mërkurës është miratuar edhe vendimi

për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të projektit për sigurinë e rrjetit të brendshëm të teknologjisë së informacionit të Policisë së Kosovës. Bëhet fjalë për mbrojtjen nga sulmet kibernetike dhe sigurinë e rrjetit të brendshëm të teknologjisë së informacionit të Policisë së Kosovës, që vlerësohet të jetë i ndjeshëm dhe konfidencial.

Qeveria e Kosovës miraton planin e punës së Zyrës për Luginën e Preshevës për vitin 2021

PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Qeveria në detyrë e Kosovës ka miratuar planin e punës së Zyrës për Luginën e Preshevës, për periudhën fillestare dymbëdhjetë mujore janar - dhjetor 2021. Aktivitetet kryesore që Zyra për Luginën e Preshevës do t'i realizojë janë implementim i përgjegjësive të dhëna me

vendimin për themelimin e saj, të mbështetura në nevojat e popullsisë shqiptare në Luginë dhe të elaboruara në një dokument si pjesë esenciale e programit të punës për 12-mujorin e parë. Qeveria e Republikës së Kosovës më 28 shtator 2020 ka themeluar "Zyrën për Ofrimin e Asistencës ndaj Qytetarëve të Luginës së

Preshevës". Sipas këtij vendimi, Zyra për Luginën e Preshevës do ta ketë përgjegjësinë që të ndërmarrë dhe t'i koordinojë të gjitha veprimet institucionale, nën mbikëqyrjen e Zyrës së Kryeministrit, në fushën e arsimit, kulturës, ekonomisë si dhe në fusha të tjera që dalin si nevojë e kohës.



OAK-u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me FIM

**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 JANAR - Në vazhden e nënshkrimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit me fakultetet të cilat qëndrojnë nën ombrellën e Universitetit të Prishtinës, një të tillë Oda e Afarizmit të Kosovës e ka nënshkruar të mërkurën edhe me Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike. "Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit, ofrimit të këshillave profesionale në fushën e inxhinierisë mekanike për bizneset anëtare të Odës së Afarizmit të Kosovës, angazhimit të studentëve të FIM në praktika profesionale pranë bizneseve anëtare të OAK-së, në pajtim me programet e studimeve, këmbimit të përvojave dhe informatave profesionale nga fusha e interesit të përbashkët, bashkëpunimit edhe në fusha të tjera, krahas fushave dhe

veprimtarive që ushtrojnë të dyja subjektet u finalizua kjo marrëveshje bashkëpunimi në të mes palëve", është thënë në komunikatën për medie të OAK-së.

Sipas kësaj komunikate, Oda e Afarizmit të Kosovës dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes këtij memorandumi të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, pajtohen që të krijojnë partneritet me qëllim të shkëmbimit dhe ofrimit të këshillave profesionale për bizneset në fushën e inxhinierisë mekanike.

Kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, me rastin e nënshkrimit të memorandumi të bashkëpunimit, ka theksuar faktin se tregu i punës ka nevojë për kadro cilësore, duke veçuar se kurrikulat dhe



planprogramet mësimore janë në shpërputhje me nevojat e tregut të punës.

Ndërkaq dekani i Fakultetit të Inxhinierisë, Ahmet Shala, ka falënderuar Odën e Afarizmit të

Kosovës për këtë bashkëpunim, duke potencuar se janë për profilizimin e fakulteteve.

Ministria e Infrastrukturës: Rrugët janë në gjendje të mirë



PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar për mirëmbajtjen dimërore të autoudhëve, rrugëve nacionale e atyre rajonale. "Në rajonin e Gjilanit 1 gjendja e rrugëve është e mirë, është intervenuar në të gjitha drejtimet në hedhjen e kripës për shkak të ngricave. Ndërsa në Gjilan 2, të gjitha rrugët janë në gjendje të mirë, në disa pjesë për shkak të reshjeve të shiut ka erodime dhe rrëshqitje të dheut në rrugën

Shipashnicë e Epërme Desivojcë në Kilometrat 55-60. Ndërsa rrugën Kamenicë-Strezoc është shembur ura, po punohet për zgjidhje alternative.

Rruga nacionale N9, Prishtinë-Pejë, në fshatin Vragoli, sot janë liruar dy shirita për qarkullimin e automjeteve", ka njoftuar kjo ministri.

Në rrugën rajonale R220 drejtimi Prilluzhe-Vushtrri lumi Sitnica ka dalë nga shtrati dhe pjesa e rrugës Prilluzhë - Mihaliq është e

mbyllur për komunikacion. Gjithashtu, edhe te Prizreni 2 është intervenuar për shpërndarjen e kripës në rrugët: R115 Prizren-Prevallë, R113 Zhur-Dragash- Restelicë, R114 Dragash-Brod. "Për shkak të temperaturave nën zero (-3) u intervenua me hedhje të kripës e të rërës në orët e mbrëmjes dhe të mëngjesit në të gjitha rrugët e regjionit Prishtina 1 si preventivë për parandalim të krijimit të ngricave në shtresat qarkulluese.

Për shkak të temperaturave nën zero, në Auto-udha R6 Doganaj - Hani i Elezit, është intervenuar me hedhje kripe si preventivë për parandalimin e krijimit të ngricave në shtresat qarkulluese", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.

Po ashtu, në Peja 1, në rrugën N9 Pejë - Klinë, është bërë pastrimi i kanaleve anësore, pasi pas vërshimeve ka pasur erodime dhe mbyllje të kanaleve. "Po ashtu, në kilometrin e 18 të

rrugës Pejë - Kuqishtë kujdestarohet 24 orë për shkak të reshjeve ka erodime dhe rrëshqitje të dheut dhe po intervenohet me ekskavator në largim të materialit. Gjithashtu, në rrugën R108 Deçan - Kozhner bëhet largimi i erodimeve", ka njoftuar ministria.

Kompanitë e mirëmbajtjes janë duke vazhduar punën në të gjitha rrugët që janë nën përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës.

Oda e Hotelerisë kundër tubimeve të partive politike



Përfaqësues të Odës së Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës (OHTK), në një konferencë për media mbajtur të mërkurën, i kanë bërë thirrje qeverisë në detyrë që t'i respektojë masat anti-Covid edhe në rastet kur partitë politike po organizojnë tubime elektorale. Kryetari i kësaj ode, Hysen Sogojeva, ka thënë se do të ngrënë edhe padi ndaj institucioneve të vendit për kompensimin e humbjeve për shkak të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë

përfundimit të pandemisë. "Duke marrë parasysh se në çfarë gjendje janë bizneset e kësaj veprimtarie dhe presionin që kemi nga këto biznese, të cilat rreth 30 mijë punëtorë i kanë të papunë dhe duke nisur nga ajo se këto masa nuk kanë dhënë asnjë rezultat deri më sot, ne kemi ftuar këtë konferencë për media sepse si odë kujdesemi për shëndetin e qytetarëve. Ju i dini masat e dy

qeverive. E para me mbyllje, ndërkaq e dyta me hapje. Në fund dolën antikushetuese. Shikoni fotografitë me tubime elektorale. Ne patëm ofruar guidën tonë, me të cilën nuk do të kishte pasur nevojë për kufizime, ka thënë ai. Kryetari i Departamentit të Estradës, Afrim Muçiqi, ka thënë se në rast se vazhdojnë tubimet elektorale, bizneset e hotelerisë

do të fillojnë ta ushtrorjnë veprimtarinë e tyre. "Po shihet që ky standard i dyfishtë qenka përdorur veç për ne. Po i pyes të gjithë politikanët, ku janë ato standarde që ju vetë i keni nënshkruar. Çfarë logjike është që të ndalohet ushtrimi i profesionit tonë? Ku janë deklaratat e këtyre zotërinjve që thoshin 'mbani maskat', 'lani duart'", është shprehur Muçiqi.



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 JANAR - Kundër tubimeve të partive politike që po mbahen këto ditë ka dalë edhe Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës (OHTK), e cila i ka bërë thirrje qeverisë në detyrë që të respektojë masat anti-Covid.

Kryetari i kësaj ode, Hysen Sogojeva, ka thënë se do të ngrënë padi ndaj institucioneve të vendit për kompensimin e humbjeve për shkak të ndalimit

të ushtrimit të veprimtarisë si arsye për respektim të masave kundër pandemisë. Ai ka thënë se 35 deri 40 për qind e bizneseve të hotelerisë janë të falimentuar, ndërsa 30 mijë persona kanë mbetur pa punë.

Sogojeva ka adresuar një kërkesë edhe për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), ku tha se kjo e fundit duhet ta shfuqizojë vendimin për ndalimin e dhënies së kredive për bizneset e hotelerisë, sipas të cilit, kjo kategori nuk mund të marrë edhe dy vjet kredi pas

Muharrem Nitaj emërohet ministër në detyrë i Ekonomisë dhe i Ambientit

PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka liruar nga detyra ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi. Në vend të

Kuçit, kryeministri Hoti në postin e ministrit në detyrë të Ekonomisë dhe të Ambientit ka emëruar Muharrem Nitaj. Të mërkurën përmes një letre, Blerim Kuçi ka

kërkuar nga kryeministri Hoti të lirohet nga detyra për shkak të angazhimeve që do t'i ketë në kuadër të fushatës për zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit 2021.



Ndahet nga jeta ish-rektori Arben Dërmaku, Haziri ngushëllon familjen

Gjilan, 13 janar (ER) - Me rastin e ndarjes nga jeta të prof. dr. Arben Dërmaku, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i ka dërguar një telegram ngushëllimi familjes Dermaku. Në telegram thuhet: "E nderuar familje Dërmaku, me pikëllim të thellë mora lajmin për ndarjen e parakohshme nga jeta të intelektualit të shquar e profesorit universitar Arben Dërmaku. Prof. Dr. Arben Dërmakun do ta kujtojmë përgjithmonë për kontributin e

jashtëzakonshëm në fushën akademike, në veçanti, për kontributin në themelimin e Universitetit Publik 'Kadri Zeka', duke qenë rektori i parë i këtij institucioni të krenarisë. Familje e nderuar Dërmaku, pranoni ngushëllimet e mia më të sinqerta. Ngushëllime edhe kolegëve profesorë të Universitetit 'Kadri Zeka' dhe Universitetit 'Hasan Prishtina', studentëve, miqve e farefisit. Lamtumirë, miku im!", thuhet në telegramin e kryetarit Haziri.



Dhjetë persona me aftësi të kufizuara, pjesë e trajnimit për rrobaqepësi



PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Handikos-i në bashkëpunim me The Balkan Forum në dhjetor të vitit të kaluar ka nisur zbatimin e projektit që ka për qëllim mbrojtjen e ambientit në Kosovë, përmes promovimit të përdorimit të çantave të ripërdorshme, zvogëlimit të përdorimit të

qeseve njëpërdorimëshe dhe mbeturinave plastike, me ç'rast në qendrën tonë janë duke u trajnuar dhjetë persona me aftësi të kufizuara. Pas përfundimit të trajnimit, këtyre dhjetë pjesëmarrësve do t'u ofrohet mundësia e punësimit me kohë të caktuar

plastike apo mundësi vazhdimi. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë të diskriminuar në fushën e punësimit në Kosovë, prandaj edhe gjithëpërfshirja e tyre duhet të merret parasysh nga çdo institucion publik apo privat, ashtu siç e parasheh edhe Ligji për Punësim.

Bulliqi viziton QKMF-në, sheh nga afër kushtet e punës

PODUJEVË, 13 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, për t'i parë nga afër kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të cilët kërkojnë shërbime mjeksore. Me këtë rast, kryetari Bulliqi bashkë me drejtorin e QKMF-së ka vizituar emergjencën, barnatoren kryesore, laboratorin dhe qendrën

anti-Covid.

Kryetari Bulliqi ka kërkuar nga personeli mjekësor angazhim dhe përkushtim në ofrimin e shërbimeve ndaj pacientëve. "Kërkoj nga stafi mjekësor që të jenë në krye të detyrës në shërbim ndaj qytetarëve, ndërsa komuna do t'i përmbushë kërkesat dhe nevojat e QKMF-së, në mënyrë që të sigurojmë shërbime cilësore për pacientët", ka deklaruar kryetari Bulliqi.



Komuna e Mitrovicës nënshkruan memorandum me organizatën "Qatar Charity"

MITROVICË, 13 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga drejtori për Bujqësi, Ekrem Sadiku, kanë pritur në takim drejtorin e organizatës "Qatar Charity", Mahmoud Abbas Shaker, me të cilin kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për ndarjen e 40 granteve në sektorin e bujqësisë për familjet me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Mitrovicës.

Në këtë takim, kryetari Bahtiri dhe drejtori i "Qatar Charity", Mahmoud Abbas Shaker, biseduan për

bashkëpunimin e suksesshëm dhe format e vazhdimin të projekteve të përbashkëta që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Me këtë rast, kryetari Bahtiri falënderoi organizatën "Qatar Charity" për mbështetjen e vazhdueshme që kjo organizatë i ka ofruar Komunës së Mitrovicës për realizimin e projekteve në sferën e mirëqenies sociale, si dhe duke mbështetur fermerët e kësaj komune. Drejtori i organizatës "Qatar Charity", Mahmoud Shaker,



i tha kryetarit Bahtiri se organizata që ai e drejton gjithmonë e ka pasur parasysh Mitrovicën gjatë përcaktimit të prioriteteve dhe se do ta ketë edhe në të ardhmen, pikërisht për shkak të gjendjes së saj specifike.

Bazuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi për vitin 2021 janë paraparë 40 grante në sektorë të ndryshëm, si mbështetja me moto kultivator, sera, bletë, lopë, për fermerët të cilët do të përzgjidhen nga vizitat e përbashkëta që do të realizohen nga të dyja palët.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë dhe pjesëmarrja e komunitetit boshnjak



Shkruan: Cerim BAJRAMI

Pas njoftimit zyrtar të vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese, ushtruesi i detyrës së presidentit të Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, njëkohësisht kryetarja e Kuvendit, ka shpallur zgjedhjet e parakohshme parlamentare për 14 shkurt 2021.

Këto janë zgjedhjet e dyta të jashtëzakonshme me radhë pas atyre të parakohshme nga qershori 2017, gjë që tregon se para skadimit të një mandati të plotë katërvjeçar zgjedhjet qendrore mbahen tri herë me radhë.

Për këtë zhvillim politik, përgjegjësit kanë partitë politike të shumicës shqiptare, por edhe disa deputetët joshumicë, më saktë partitë e tyre.

Por çka do që është, ne nuk kemi pasur mundësi ta ndryshojmë atë.

Jemi gjithashtu të vetëdijshëm për pakënaqësinë në popullin tonë boshnjak për shkak të përsëritjes të shkuar në votime, në kohën e virusit Covid-19 për shkak të të cilit shumë gjëra janë të kufizuara gjithsesi. Ku janë boshnjakët e Kosovës përpara këtyre zgjedhjeve?

Duke gjykuar nga gatishmëria për të formuar parti dhe iniciativa të reja, është e qartë se boshnjakët nuk kanë qenë kurrë se deri më tani më të ndarë. Dhe këto subjekte të reja janë duke u formuar në Prizren dhe rajoni i Zhupës, pa përfshirë Podgorës, në të cilën kanë mbetur një numër relativisht më i madh i boshnjakëve të Kosovës.

Ndarjet politike boshnjake kanë shumë shkaqe. Ka edhe lëshime subjektive të partive të mëparshme politike, udhëheqësve të tyre, dmth. deputetëve të Kuvendit, të cilët po punojnë më shumë për interesat e tyre personale.

Sidoqoftë, këto ndarje politike janë stimuluar kryesisht nga jashtë. Gjegjësisht nuk janë ndaluar asnjëherë aktivitetet anti-boshnjake nga Serbia, e së cilës strukturat përdorin disa aktivitetet dhe simpatizantët e tyre të vjetër politikë të para

luftës, këtu në Kosovë ose një numër më të vogël të atyre që u vendosën në diasporë, para dhe pas luftës në Kosovë.

Gjithashtu, në vitet e fundit, në veçanti ndarjet politike të boshnjakëve janë përkrahur apo forcuar nga disa parti më të mëdha shqiptare, me qëllimin e qartë të dobësimit të paraqitjes së përbashkët të tre deputetëve në vendet e garantuara boshnjake në Kuvendin e Kosovës.

(Rasti i fundit: dy deputetë turq nga një parti politike së bashku kapërcyen tre deputetë të ndarë boshnjakë dhe në qeverinë aktuale morën një pozicion ministror për komunitetin joshumicë/joserbe.)

Në ndihmë të atyre ndarjeve politike boshnjake prapa skenave dhe hapur marrin pjesë edhe disa ish-përfaqësues politikë boshnjakë të cilët, duke stimuluar një atmosferë mosmarrëveshjes të komuniteti boshnjakë, duan ta mbulojnë përgjegjësinë e tyre të kaluarën për një numër të dështimeve strategjike nga (mos)regjistruar drejtat e boshnjakëve, duke filluar nga ato në plan të presidentit Marti Ahtisarit, përmes të drejtave në

Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, e deri në strategjinë e gabuar në adresimin e nevojave praktike të arsimit në gjuhën boshnjake...

Nga ana tjetër, ndarja e fundit politike në Kuvendin e Kosovës në tri anët, në vend të përfaqësimit të mëparshëm solid të boshnjakëve të dy deputetëve nga koalicioni Vakati, vetëm më tej tregoi se nuk ka as mundësi teorike për koalicion paszgjedhore, ose marrëveshje për veprim të përbashkët për çështje të interesit kombëtar boshnjakë.

Për këto dhe shumë arsye të tjera, veçanërisht për shkak të përfundimit të ardhshëm të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shumë sfidave të tjera, tashmë të dukshme për komuniteteve joshumicë dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, si dhe për shkak të çështjeve specifike kombëtare boshnjake të cilat duhen të adresohen në institucionet, boshnjakët e Kosovës, më saktë udhëheqësit e subjekteve të tyre politike, nuk duhet t'i lejojnë vetës luksin për të kandiduar shumë subjekteve politike në zgjedhje. Gjithsesi, listë zgjedhore është

e hapur, dmth. votohen pesë kandidatë/e, dhe fitojnë ata ose ato që ka numrin më të madh të votave.

Koalicioni Vakati, tri subjektet e tyre, është më e përgjegjshme në këtë moment për ta ruajtur unitetin e tij politik, dhe me këtë të ruajë edhe deri tash qartë të shprehur platformën nacionale e komunitetit boshnjak në Kuvendin, Qeverinë dhe shoqërinë e Republikës së Kosovës. Ndërsa të gjitha subjektet e tjera, të vjetra dhe të reja, janë të mirëseardhura në koalicion, sipas rregullave të vlefshme dhe me marrëveshjet e nënshkruara të koalicionit.

Në këtë emër do të ishte mirë t'u tregojmë të gjithëve pavarësisht mungesës së autoriteteve të jashtme, cilit do t'i "ndërpresë" dyshimet dhe inatet tona për një veprim të përbashkët - të jemi të gatshëm të ngrihem mbi interesat personale dhe t'i tregojmë shumicës që ne mund të jemi bashkë, të paktën kur është e nevojshme për interesin tonë kolektiv.

Tekefundit, mbi të gjitha secili prej nesh është përgjegjës për veprimet e tij si para Zotit, ashtu edhe para njerëzve.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Synojmë Superkupën, por fokusi kryesor është në Kupë

“Janë dy gara të ndryshme dhe patjetër që fokusi kryesor në përballje me Dritën do të jetë për Kupë. Superkupa është ndeshje prestigji dhe me siguri do të jetë ndeshja jonë e parë në fazën përgatitore. Normalisht do të provojmë atë trofe, por përqendrimi ynë maksimal është ndeshja e Kupës më 10 shkurt, sepse kuptohet është garë që na sjell Evropën dhe aty do të jetë përkushtimi ynë maksimal”, ka thënë Ramadani

PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - FC Prishtina është duke i vazhduar përgatitjet për stinorin pranveror. Ky klub pritet që më 19 janar të udhëtojë në Antalya të Turqisë, ku do ta zhvillojë ndeshjen e Superkupës kundër Dritës së Gjilanit më 23 janar. Trajneri i kryeqytetasve të Kosovës, Zekirija Ramadani, ka folur për faqen zyrtare të klubit për ndeshjen e Superkupës, por edhe për ndeshjen e 1/8 së finales së Kupës që do t'i zhvillojë ndaj Dritës. Ai ka thënë se përqendrimi kryesor është në ndeshjen e Kupës, por edhe në Superkupë do të mundohen që të triumfojnë. “Janë dy gara të ndryshme dhe patjetër që fokusi kryesor në përballje me Dritën do të jetë për Kupë. Superkupa është ndeshje prestigji dhe me siguri do të jetë ndeshja jonë e parë në fazën përgatitore. Normalisht do të provojmë atë trofe, por përqendrimi ynë maksimal është ndeshja e Kupës më 10 shkurt, sepse kuptohet është garë që na sjell Evropën dhe aty do të jetë përkushtimi ynë maksimal”, ka thënë Ramadani. “Shorti është i rëndë, por e mira është që luajmë vendas. Drita është kampione aktuale, është kampione vjeshtore, kundërshtarë e fortë dhe e respektuar, pra short i rëndë, por e mira është që luajmë si vendas, shumë më mirë se po të luanim në Gjilan”, ka shtuar Ramadani.

Trajneri foli edhe për gjendjen e futbollistëve “bardhekaltër”, ku bëri me dije se futbollistët po tregojnë karakter të lartë dhe në



pranverë do të jenë në formë të lartë. “Ekipi është mirë, nuk kemi asnjë lëndim më të vogël dhe futbollistët janë duke e dhënë maksimumin në këto kushte që i kemi dhe në këto rrethana po provojmë ta përgatisim ekipin sa më mirë që është e mundshme. Futbollistët janë duke treguar karakter në çdo seancë stërvitore, pa marrë parasysh se fusha është e mbuluar me borë dhe jam i bindur që do të jemi shumë më mirë se në stinorin vjeshtor”, ka pohuar Ramadani. Në fund trajneri Ramadani foli edhe për përfundime, kurse bëri me dije se

me gjasë nuk do të ketë përfundime të tjera, por as largime. “Më nuk do t'i lirojmë futbollistët dhe me gjasë nuk do të ketë as ardhje tjetër. Me gjithë disa kontakte, ne kemi thënë që çdo ardhje e re duhet të jetë të paktën i barabartë me cilësitë që posedojmë, ose më i mirë. Nëse nuk kanë cilësi, atëherë ne më nuk kemi nevojë për futbollist vetëm sa për numër, thjesht na duhet vetëm cilësia”, ka përfunduar Ramadani. FC Prishtina sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e tretë me 32 pikë, kurse ka regjistruar 9 fitore, 5 barazime dhe 4 humbje.

SHKURT

Rriten shpërblimet në Superligën e femrave

Bordi i Federatës i Basketbollit të Kosovës ka vendosur që ta rrisë fondin e shpërblimeve për Superligën e Femrave: 6 000.00 (gjashtë mijë) euro për ekipin kampion, 3 000.00 (tre mijë) euro për ekipin nënkampion dhe nga 1 000.00 (një mijë) euro për ekipet që e sigurojnë nga një vend në “play-off”. Kjo është edhe një ndihmë për klubet e femrave nga Bordi i FBK-së që po synon të ndihmojë sa më shumë basketbollin e femrave në Kosovë.

Vitin e kaluar bordi i FBK-së ka vendosur që të formohet Përfaqësuesja A e femrave dhe të luajë në garat ndërkombëtare. Në Superligën e Meshkujve e ka konfirmuar fondin e shpërblimeve nga viti i kaluar: 12 000.00 (dymbëdhjetë mijë) euro do t'i ndahen ekipit kampion, 6 000.00 (gjashtë mijë) euro për ekipin nënkampion dhe nga 3 000.00 (tre mijë) euro do të ndahen për ekipet që e sigurojnë nga një vend në katërshen e madhe.

Nuk dihet sa do të mungojë Vojvoda

Mbrojtësi Mërgim Vojvoda u lëndua në ndeshjen që e zhvilloi të mërkurën Torino kundër Milanit, duke u zëvendësuar tetë minuta pa përfunduar ndeshja. Skuadra italiane nëpërmjet një komunikate për media ka konfirmuar lëndimin e futbollistit të Përfaqësueses së Kosovës. “Lojtari do të jetë subjekt i vlerësimeve të mëtutjeshme në ditët në vazhdim”, thuhet në njoftimin e Torinos.

Beqiri ndahet me Trepçën '89, karrierën e vazhdon te Vushtrria

Portieri Arben Beqiri është larguar pas disa viteve nga Trepça '89. Portieri i njohur mitrovicës ka ndarë rrugët me ‘Minatorët’ me marrëveshje të dyanshme. Gardiani mitrovicës ka arritur marrëveshje me Vushtrrinë ku do t'i mbrojë ngjyrat “bardhekaltër” në edicionin pranveror në Ligën e Parë. Beqiri ka përvojë të madhe në futbollin e Kosovës dhe pritet ta ndihmojë Vushtrrinë për t'i arritur objektivat.

Milani e ka seriozisht interesimin për Gjimshitin

AC Milan po mendon seriozisht për Berat Gjimshitin. Lajmin e kanë bërë me dije mediat italiane të cilat flasin për një këmbëngulje të drejtorit Paolo Maldini për shërbimet e mbrojtësit shqiptar. Oferta e Milanit mund ta joshë Gjimshitin që ka një kontratë deri në vitin 2023 me klubin aktual. Ai vlen 15 milionë euro, gjë që nuk do të ishte ndonjë problem për t'u paguar nga klubi kuqezi. Gjimshiti do të ishte alternativa e parë për ta zëvendësuar njërin mes Kjaerit dhe Romanjolit, por edhe prestigji i Milanit si klub mund ta tundojë djaloshin e lindur në Zyrin për ta tentuar hapin e madh në karrierë dhe mundësinë për të qenë pjesë e një klubi historik dhe me shumë ambicie.

Loriana ia siguron Kosovës medaljen e katërt në Doha

PRISHTINË, 13 JANAR - Xhudistja Loriana Kuka ia ka siguruar Kosovës medaljen e katërt në Mastersin e xhudos në Doha të Katarit. Kuka e rrëmbeu medaljen e bronzit, pasi në luftë

kryesore e mposhti me Ippon në kategorinë deri 78 kilogramë britaniken Natalie Powell. Loriana në luftën e parë e mposhti me ippon Sarah-Myriam Mazouzin e Gabonit. Ndërsa në raundin

e dytë, Kuka e mposhti francezen Audrey Tcheumeo, por në çerekfinale është mposhtur nga japonezja Shori Hamada. Më pas xhudistja pejane e mposhti kubanezen

Kaliema Antomarchi dhe në fund britaniken Natalie Powell. Medaljen e artë në Doha e fitoi Distria Krasniqi, kurse të bronzit i fituan Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova.



Liria prezanton përforcimet

PRIZREN, 13 JANAR (ER) - Skuadra e Lirisë së Prizrenit ka prezantuar përforcimet e bëra. Bëhet fjalë për Martin Kovachev, qendërmbrojtës (Makedonija G. Petrov), Miljan Vlasisavljeviç, mesfushor krahu/sulmues, e

Borislav Bladziyski, mesfushor. Nga Ballkani kthehen portieri Armend Rugji, mesfushori Roni Gashi dhe sulmuesi i krahut, Liridon Fetahaj. Albin Berisha ka vazhduar huazimin nga Ballkani edhe për pjesën pranverore.

“Pritet që ditët në vijim të vijë një qendërmbrojtës dhe një mbrojtës”, ka thënë kryetari i klubit Qemal Krasniqi. Nga klubi me marrëveshje janë liruar Diar Mustafa, Egzon Krasniqi, Blazho Igumanoviq,

Ardian Hoti dhe Jetlir Berisha (i huazuar në FC Prizreni). Liria nga 7 janari ka nisur fazën e përgatitjeve për stinorin pranveror, kurse në fund të muajit udhëton

më Durrës për përgatitje dyjavore.



Davitkovi emërohet trajner i KB Peja

PEJË, 13 JANAR - KB Peja nuk ka humbur kohë dhe e ka emëruar trajnerin e ri. Fjala është për Jordanço Davitkov, i cili ka qenë trajner i Maqedonisë së Veriut për shumë vite me radhë. “Trajneri Davitkov ka qenë trajner i reprezentacionit të Maqedonisë së Veriut për vite me radhë. Ai kualifikoi Maqedoninë e Veriut në Kampionatin Evropian të vitit 2003. Ai, gjithashtu, ka qenë trajner i reprezentacionit të Kuvajtit, ku arriti vendin e tretë në garat e shteteve të Lindjes së Mesme”, thuhet në njoftimin e KB Peja. Davitkov, gjithashtu, ka udhëhequr më shumë sukses skuadra të ndryshme si ajo e Rabotniçkit me të cilën është shpallur 4 herë kampion dhe 4 herë fitues i Kupës në Maqedoninë e Veriut, pastaj është shpallur kampion edhe me



ekipin e tij në kampionatin e Kuvajtit si dhe fitues i Kupës. Trajneri Davitkov është shpallur trajneri i vitit në Maqedoninë e Veriut tri herë dhe njihet si një ndër trajnerët më të mirë maqedonas i të gjitha kohëve. Siç dihet nga KB Peja ka dhënë dorëheqje trajneri Semsetin Bas

për shkak të arsyeve familjare, ndërsa të martën në klubin pejan është rikthyer basketbollisti Leonard Mekaj. Gazeta ka mësuar se basketbollisti më i mirë vendor, Dardan Berisha, nuk do të largohet nga Peja të paktën deri në fund të këtij kampionati.

Lakersat triumfojnë sërish ndaj Rocketsit, fitojnë edhe Brooklynin e Spursit

HOUSTON, 13 JANAR - Houston Rocketsit dhe Los Angeles Lakersit përballen për herë të dytë këtë sezon dhe edhe në “Toyota Center” ishin sërish kampionët në fuqi ata që ia dolën të triumfojnë me shifrat 100-117, ndërsa vendësit treguan sërish dobësi. LeBron James ishte protagonist absolut për kalifornianët, pasi shënoi 26 pikë, rikuperoi 8 topa dhe dha 5 asistime, shifra që mund të ishin edhe më të mira po të mos ishte ulur në bankinë në pjesën e fundit për t’u ruajtur nga një dëmtim. Një ndeshje mjaft të mirë bëri edhe ylli tjetër i skuadrës kaliforniane Anthony Davies, ndërsa lideri i Houston Rocketsit, James Harden, vijon të kalojë një moment të errët, pasi nuk shkoi dot përtej 16 pikëve të shënuara. Një sfidë mjaft spektakolare u zhvillua edhe në “Wells Fargo Center” mes Philadelphia 76ers dhe Miami Heat, dy skuadra që vinin në këtë ndeshje të gjymtuara nga dëmtimet dhe protokollin i koronavirusit, që për më tepër patën nevojë edhe për 5 minuta shtesë që ta përcaktonin fituesin. Sfida ishte vërtet e balancuar, me vendasit që fituan fraksionin e parë dhe të tretë, ndërsa miqtë nga Miami të dytin dhe të katërtin,



ndaj koha e rregullt përfundoi në barazim 120-120, ndërsa koha shtesë u buzëqeshi 76ers-ave që fituan të gjithë ndeshjen me shifrat 137-134. Një formë të shkëlqyer shfaqti basketbollisti kamerunas Joel Embiid, që shënoi plot 45 pikë, rikuperoi 16 topa dhe dha 4 asistime, duke qenë protagonist absolut i suksesit të Philadelphia 76ers, raporton “SS”. Demar DeRozan vijon të mungojë për San Antonio Spursin, por këtë herë skuadra e drejtuar nga Gregg Popovich nuk e ndjeu aspak, pasi ia doli të triumfojë me shifrat 102-112 në transfertën ndaj Oklahoma City Thunderit. Lonnie Walker u shfaq protagonist për Spursat në këtë takim, pasi e mbylli ndeshjen me 24 pikë të shënuara, ndërsa Oklahoma City Thunderi nuk ia doli të vijojë më tej serinë prej 3 fitoresh radhazi. Nuk arriti ta vijojë ecurinë pozitive as Golden State Warriors, që u

mposht në shtëpi me shifrat 95-104 ndaj Indiana Pacersit. Kalifornianët e nisën shumë mirë ndeshjen dhe fituan fraksionin e parë, por më pas u venitën gradualisht, edhe për faktin se ylli i ekipit, Stephen Curry, nuk arriti të ngjitej në nivelin e pritshmërive. Pas dy humbesh radhazi, Brooklyn Nets ia doli të rikthehet te fitorja, pasi mposhti në “Barclays Center” Denver Nuggets me rezultatin 122-116. Miqtë nga Denveri e nisën mjaft mirë ndeshjen dhe fituan dy fraksionet e para me rezultatin identik 27-35, por reagimi i Netsit ishte fantastik në gjysmën e dytë të lojës. Protagonist absolut ishte ylli i Brooklynit, Kevin Durant, i cili shënoi 34 pikë, rikuperoi 9 topa në tabelë dhe dha 13 asistime, ndërsa serbi Jokiç nuk shkoi përtej 23 pikëve, 8 rikuperimeve dhe 11 asistimeve.

REZULTATET

Philadelphia - Miami	137-134
Brooklyn - Denver	122-116
Cleveland - Utah Jazz	87-117
Chicago - Boston (e shtyrë)	
Houston - Lakers	100-117
Oklahoma - San Antonio	102-112
Golden State - Indiana	95-104

SHKURT

Babai i Hamiltonit: Lewisi do të vijojë të pilotojë

Ditët kalojnë dhe Lewis Hamiltoni vijon të jetë pa kontratë për vitin 2021. Shtatë herë kampioni i botës ende nuk ka rinovuar me Mercedesin, teksa ngërçi kryesor është rroga që do të ketë piloti britanik, shumë e lartë për makinën gjermane. Ai që është përpjekur të hedhë sadopak dritë në këtë çështje është Anthony Hamiltoni, babai i pilotit, i cili ka deklaruar: “Për aq sa unë di, Lewisi do të vijojë të pilotojë. I dashuron garat dhe dashuron gjithçka që bën”. “Lewisi është një zë me shumë peshë në botën e këtij sporti dhe do të vijojë të garojë. Kam vetëm pak orë që kam folur me të, ndaj e di me siguri këtë gjë. Lewisi nuk garon për trofe, por sepse e dashuron këtë që bën”, ka shtuar babai i Lewis Hamiltoni.

Chelsea e ka Allegrin të parin në listë

Ish-trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, i cili aktualisht ndodhet pa skuadër, është vendosur në majën e listës së preferencave të bosit të Chelseat, Roman Abramovich. Tekniku livornez është i parapëlqyeri i manjatit rus për bankinën e bluve të Londrës pasi Frank Lampard nuk po bind me rezultatet e tij. Sipas asaj që shkruan “Sport BILD”, nëse nuk arrihet tek Allegri, ekipi nga “Stamford Bridge”, ka në listë dhe trajnerë të tjerë si Thomas Tuchel, Brendan Rodgers, Ralf Hasenbuttel dhe Julian Nagelsmann.

Barça interesohet për Agueron

Barcelona në afatin kalimtar të verës pritët të përforcohet me yllin e Manchester Cityt, Sergio Agueron, njofton “The Sun”. Argentinasi ka kontratë me Cityn deri në qershor dhe mund të jetë një transferim me parametra zero. Interesim për Agueron ka shfaqur edhe PSG-ja. 32-vjeçari është pjesë e klubit anglez nga viti 2011, derisa ka regjistruar 268 paraqitje dhe ka shënuar 180 gola.

Presidenti i Napolit kërkon 112 milionë euro për Koulibaly

Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, është një negociator i vështirë. Sipas “The Sun”, ai tashmë ka paralajmëruar Manchester Unitedin dhe Liverpoolin se çfarë duhet të paguajnë, nëse duan të marrin Kalidou Koulibaly në këtë janar. Udhëheqësi i lartë i bluve e ka vlerësuar mbrojtësin qendror, 29-vjeçarin senegalez, me 112 milionë euro. Ose kjo shumë, ose asgjë, nuk ulet në tryezën e bisedimeve me askënd. Dy klubet e njohura angleze, të interesuara për “bishën” e mbrojtjes, janë qartësisht të paralajmëruara.

Palmeiras pas 20 vjet pritje kualifikohet në finale të Kupës Libertadores

Palmeiras është finalistja e parë e Kupës Libertadores. Skuadra braziliane kthehet të luajë aktin final të turneut më të rëndësishëm të futbollit për klube në Amerikën e Jugut, pas një mbrëmje dramatike në gjysmëfinalen e kthimit kundër River Plates. Formacioni argjentinas kishte humbur sfidën e parë në shtëpi me rezultatin 3-0, ndërsa në atë të kthimit iu afrua një përmbysje të madhe, por u ndal në fitoren 2-0. Miqtë kaluan në epërsi me Rojas në minutën e 29. Në limitet e pjesës së parë, Borre dyfishoi rezultatin duke nderuar shpresat e River Plate. Me rikthimin në fushë, argjentinasit ndalën sërish topin në rrjetë, por festa e tyre u prish nga sistemi VAR që sinjalizoi një pozicion jashtë loje. Misioni i tyre për përmbysje u vështirësua pas kartonit të kuq të Rojas, ndërsa me një lojtar më pak River Plate nuk arriti t’i rrëmbejë Palmeriras biletën e parë për në finalen e 30 janarit që do të luhet në mitikon “Maracana”.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm, Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës, me datën 14 janar 2021 bënë:

SHPALLJE PUBLIKE

I. Për angazhimin afatshkurtër të një (1) Eksperti të jashtëm për inxhinieri të ndërtimitarisë/infrastrukturës rrugore.

II. Qëllimi i angazhimit të ekspertit është përkrahja profesionale e ekipit për kryerjen e auditimit të performancës në projektin “Vlera për para për ndërtimin e rrugëve lokale”.

III. Periudha e angazhimit

Eksperti i përzgjedhur do të angazhohet në bazë ditore për 14 ditë pune, të cilat do të realizohen në fazat e caktuara të auditimit brenda periudhës nga muaji shkurt 2021 deri në muajin korrik 2021.

Marrëveshja lidhet sipas dispozitive të aplikueshme të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Për punën e kryer bëhet kompensimi në vlerën e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm.

IV. Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kriteret:

1. Diplomë universitare në lëminë e ndërtimitarisë, me përparësi drejtimi i inxhinierisë së infrastrukturës rrugore;
2. Së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën përkatëse pas diplomimit;
3. Të ketë dëshmi se ka **hartuar/menaxhuar** së paku 3 projekte nga lëmia e kërkuar (hartimi i projekteve për: ndërtimin e rrugëve, urave dhe objekteve tjera përcjellëse për rrugët-preferohet përvoja në rrugë rajonale dhe lokale);
4. Të ketë gatishmëri të punoj në ekip dhe në mënyrë të pavarur.

V. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

1. Biografi (CV); 2. Letër motivuese; 3. Kopjen e letërnjoftimit; 4. Dëshminë për studimet universitare; 5. Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse për periudhën e kërkuar; 6. Kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka); dhe 7. Referencat për punët e mëparshme në lëminë e hartimit/menaxhimit të projekteve apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.

VI. Përzgjedhja e kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas procedurës së përcaktuar me Udhëzimin e Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm.

Eksperti i angazhuar duhet të respektojë standardet e zbatueshme të auditimit të njohura ndërkombëtarisht, Kodin e Etikes dhe rregullat tjera të përcaktuara me aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Termat e referencës së bashku me qëllimin e angazhimit si dhe përshkrimin e punës mund të merren nga faqja e internetit të Zyres Kombëtare të Auditimit, në <http://www.zka-rks.org/>

VII. Dorëzimi i dokumenteve

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, në adresën: **Prishtinë, rruga Ahmet Krasniqi nr. 210 ose përmes postës elektronike: rekrutimi@oagks.org**

Dokumentacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumentet e (jo ato që janë vetëm të deklaruara, pa dëshmi).

Mundësia për aplikim mbetet e hapur **tetë (8) ditë kalendarike** nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën 22 janar 2021, në ora 16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore të ZKA-së, në numrin e tel: 038 606-004 lok. 1005, çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 12.2 Zakona Br.05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosovo i članom 4 Administrativnog Uputstva Br. 02/2017 o Angažmanu Spoljnih Stručnjaka, Nacionalna Kancelarija Revizija Republike Kosovo, dana 14 januara 2021 objavljuje:

JAVNI OGLAS

I. Za kratkoročno angažovanje jednog (1) Stručnjaka u inženjeringu putne građevinarstva/infrastrukture

II. Svrha angažovanja stručnjaka je stručna podrška tima da izvrši reviziju učinka u projektu „Vrednost novca za izgradnju lokalnih puteva“.

III. Period angažovanja

Izabrani stručnjak biće angažovan svakodnevno u trajanju od 14 radnih dana, koja će se obavljati u određenim fazama revizije unutar perioda od februara 2021 do jula 2021 godine.

Sporazum se zaključuje u skladu sa primenjivim odredbama Zakona o Obligacionim Odnosima. Za izvršeni rad pruža se nadoknada u iznosu koji je utvrđen Administrativnim Uputstvom Br.02/2017 o Angažovanju Spoljnih Stručnjaka.

IV. Kandidati koji izražavaju interesovanje za angažman treba da ispune sledeće kriterijume:

1. Univerzitetsku diplomu u oblasti građevinarstva, sa prioritetom u inženjeringu putne infrastrukture;
2. Najmanje 5 (pet) godina radnog iskustva nakon diplomiranja, u određenoj oblasti;
3. Da ima dokaze da je **izradio/rukovodio** najmanje 3 projekata iz zahtevne oblasti (izrada projekata za: izgradnju puteva, mostova i drugih propratnih objekata za puteve-poželjno je iskustvo na regionalnim i lokalnim putevima);
4. Da ima spremnost da radi u timu i nezavisno.

V. Kandidati treba da podnesu sledeća dokumenta:

1. Biografiju (CV); 2. Motivaciono pismo; 3. Kopiju lične karte; 4. Dokaze o univerzitetskim studijama; 5. Dokaze o radom iskustvu u određenoj oblasti za traženi period; 6. Kopije o završene odgovarajuće obuke (ako ih imaju); i 7. Reference o prethodnim poslovima u oblasti izgradnje/upravljanja projekata ili druge dodatne informacije, koje se smatraju važnim za kandidata koji podnosi zahtev.

VI. Izbor kandidata

Izbor kandidata se vrši u skladu sa procedurama koje su utvrđene Administrativnim Uputstvom Br. 02/2017 o Angažovanju Spoljnih Stručnjaka.

Angažovani stručnjak treba pridržavati primenjive međunarodno priznate standarde revizije, Kodeks e Etike kao i ostala pravila koja su utvrđena aktima Nacionalne Kancelarije Revizije.

Projektni zadatak zajedno sa svrhom angažmana kao i sa opisom radnih zadataka može se skinuti sa internet stranice Nacionalne Kancelarije Revizije, na <http://www.zka-rks.org/>


VII. Podnošenje dokumenata

Dokumenti se podnose u Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosovo, na adresi: **Priština, ulica Ahmet Krasniqi br. 210 ili preko elektronske pošte: rekrutimi@oagks.org**

Dokumentacija koja pristiže posle roka kao i ne kompletirana dokumentacija, neće se razmotriti. Kao tačne i verodostojne informacije smatraće se samo one koje su dokazane dokumentima (ne one koje su samo izjavljene a nemaju dokaze).

Mogućnost za apliciranje ostaje otvorena **osam (8) kalendarskih dana** od dana objavljivanja, odnosno do 22 januara 2021, u 16:00 časova.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Odeljenju za Ljudske Resurse NKR-a, na broj telefona: 038 606-004 lok. 1005, svakog radnog dana od 08:00-16:00.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Besim Zeqiri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Premtim Beqiraj shpall të pavlefshme ID- e Fakultetit të Arkitekturës në UP.

► M.H. Inter-Carter O.P. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70029567 si dhe me nr Unik 810487125.

► Altin Ramadani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Bajram Curi " Krush e Madhe.

► Behar Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Imer Totaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Zenun Cocaj " Gjonaj.

► Adelina Gigollaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesë e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

